



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
AGJENCIA PËR INFORMIM DHE PRIVATËSI
AGENCIJA ZA INFORMACIJE I PRIVATNOST
INFORMATION AND PRIVACY AGENCY



Nr. 58 /2025

Datë: 22.04.2025

Agjencia për Informim dhe Privatësi, Zyrta i Inspektimit, duke vepruar në pajtim me nenin 64, paragrafi 1, nënparagrafi, 1.5, neni 68, nenin 69, paragrafi 1, nenin 71, paragrafi 1, nënparagrafi 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, nenin 13, (paragrafi 3, nënparagrafi 3.1) të Rregullores Nr.04/2022 për Procedurën e Brendshme për Shqyrtimin e Ankesave për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, pas shqyrtimit të ankesës me nr. 98 të protokollit të dt. 21.01.2025, të parashtruar nga subjekti i të dhënave, ndaj kontrolluesit Zyra e Kryeministrit.

V E N D I M

1. **Aprovohet** ankesa me numër të protokollit 98, e datës 21.01.2025, e parashtruar nga subjekti i të dhënave z. A.A, ndaj Zyrës së Kryeministrit, në cilësinë e kontrolluesit.
2. **Urdhërohet** Zyra e Kryeministrit, me adresë: Ndërtesa e Qeverisë, Sheshi “Nënë Tereza”, Prishtinë, të ndaloj shpërndarjen e të dhënave personale bazë ligjore.
3. **Obligohet** kontrolluesi që përpunimin e të dhënave personale, ta bëjë në harmoni me dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.
4. **Obligohet** kontrolluesi që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga pranimi i këtij vendimi, të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për zbatim të këtij vendimi dhe ta njoftojë Agjencinë për Informim dhe Privatësi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të vendimit.



Agjencia për Informim dhe Privatësi (Agjencia), më datë 21.01.2025, ka pranuar ankesë përmes postës elektronike (e-mail) që mbanë nr. 98 të protokollit, të parashtruar nga subjekti i të dhënave personale z. A.A, në lidhje me atë se, nga njësia e arkivit dhe zyrtarja për qasje në dokumente publike në Zyrën e Kryeministrit, janë shpërndarë të dhënat personale si: dokumenti identifikues, adresa e banimit etj, pa bazë ligjore. Në ankesën e tij pala ankese ka shpjeguar se: më datë 23 dhjetor

2024, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës në Shërbimin Civil të Kosovës (KPMSHCK) lidhur me kontestimin e konkursit në Zyrën e Kryeministrit. Ankesa është bërë kundër Vendimit nr. 14/233, 27.11.2024, të marrë në mbledhjen e Qeverisë së Republikës së Kosovës, të datës 27.11.2024. Pas ankesës së tij në KPMSHCK, Këshill, me datë 10 janar 2025, ka dërguar kërkesën në Njësine për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore (NjBNj) në Zyrën e Kryeministrit (ZKM), që për shkak të efikasitetit të punës, në pajtim me nenin 17, paragrafi 3 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës në Shërbimin Civil të Kosovës, të ofrohen përgjigje të ndryshme në ankesën e lartpërmendur drejtuar KPMSHCK. Kjo korrespondencë, përmes postes elektronike, është bërë nga zyrtari i KPMSHCK-së tek zyrtarët e NjBNj-së të ZKM-së. Në lëndë është bashkëngjitur ankesa e ankuesit me të dhëna personale duke përfshirë adresën e banimit, provat e parashtruara nga ana të njëjtit, shkresa përcjellëse për dorëzimin e ankesës në KPMSHCK, si dhe letërnjoftimi i skanuar në dy anë. Në të njëjtën ditë NjMBNJ në ZKM, ka përcjellë në formë fizike lëndën për protokollim në Arkivin e ZKM-së. Njësia e Arkivit, pas protokollimit të shkresës-dokumentit, ka njoftuar përmes e-mailit se dokumenti është protokolluar me Nr.28 dhe është vendosur në postën e BNJ. Në këtë njoftim kanë qenë të përfshirë afër 30 zyrtarë publik në ZKM të cilët iu është shpërndarë kjo lëndë, të cilët zyrtarë sipas deklaratimit të palës ankuese nuk kanë asgjë të bëjnë me materien e çështjes së dërguar nga KPMSHCK.

Me këtë rast, pala ankuese pasi që është njoftuar gojarisht përmes disa kolegëve, lidhur me shpërndarjen e të dhënave personale të tij, subjekti i të dhënave me datë 20.01.2025, ka parashtruar tek zyrtarja përgjegjëse për qasje në dokumente publike në ZKM, kërkesë për qasje në dokumente që ndërlidhen me procedurën e ankesës për të qenë i komunikimit të KPMSHCK-së me Njësine për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në ZKM. Me këtë rast, nga zyrtarja për qasje në dokumente publike ka pranuar përgjigjen, në të cilin me fjalë të thjeshta thuhet që, “në kuadër të bashkëpunimit ndërinstytucional, ju njoftojmë se Zyra e Kryeministrit ju ka dhënë qasje në dokumentet e kërkuara nga ana juaj, të cilat mund t’i gjeni bashkëngjitur”. Në këtë përgjigje të pranuar përmes postës elektronike (e-mail), zyrtarja për qasje në dokumente publike, ka përfshirë sërish zyrtarë që nuk ishin pjesë e procedurës dhe pa autorizim ka shpërndarë të dhënat e tij personale, përfshirë dokumenti identifikues adresën e banimit, etj. Në këtë përgjigje janë përfshirë: Ministrija e Drejtësisë, Këshilltari i Lartë dhe Shef Kabineti i Ministres, Sekretarja e Përgjithshme e Ministrisë së Drejtësisë dhe Koordinator i Zyrës për Informim në ZKM.

Bazuar në nenin 68, paragrafi 1, dhe nenin 69, të Ligjit Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (LMDhP), Agjencia përmes zyrtarëve të inspektimit, ka filluar procedurën e shqyrtimit të ankesës për të vërtetuar pretendimet e palës ankuese. Me këtë rast, zyrtari i inspektimit, ka shqyrtuar kërkesën e parashtruar nga KPMSHCK, në Njësine për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore (NJMBNJ) në ZKM, ku është konstatuar se për të dhënat e kërkuara nga KPMSHCK, është përgjegjëse NJMBNJ në ZKM, e cila ka përcjellë lëndën për protokollim në Zyrën e Arkivit. Mirëpo, me këtë rast, pas protokollit të lëndës zyra e arkivit ka njoftuar NJMBNJ, lidhur me protokollimin e lëndës (posta 028), në të cilën kanë qenë të bashkëngjitura të gjitha dokumentet që kanë të bëjnë me këtë lëndë, duke i mbajtur të njoftuar (CC) edhe zyrtarë të tjerë të cilët nuk janë përgjegjës lidhur me kërkesën e parashtruar nga KPMSHCK. Kjo lëndë përmban të dhëna personale të subjektit të të dhënave (ankuesi) si emri, mbiemri, adresa dhe dokumenti identifikues i skanuar

në të dy anët. Gjithashtu zyrtari i inspektimit, ka shqyrtuar edhe përgjigjen e dhënë nga zyrtari për qasje në dokumente publike përmes postës elektronike, për subjektin e të dhënave personale (kërkuesin/ankuesin), ku është konstatuar se në këtë përgjigje janë mbajtur në të njoftuar (CC) persona e lartcekur në ankesë të cilët nuk kanë qenë përgjegjës për dhënien e përgjigjes për qasje në dokumente publike.

Tutje, më datë 12.02.2025, zyrtari i inspektimit, iu është drejtuar zyrtares për mbrojtjen e të dhënave personale në ZKM, e cila është njoftuar me ankesën dhe nga e njëjta është kërkuar të na njoftojë me bazën ligjore e cila i mundëson shpërndarjen e të dhënave personale tek personat të cilët janë mbajtur në dijeni (shpërndarë të dhënat personale) përmes postës elektronike nga zyra e arkivit me rastin e njoftimit të NjMBNj-së për protokollimin e lëndës dhe nga zyrtarja për qasje në dokumente publike me rastin e njoftimit të palës kërkuese, subjektit të të dhënave, lidhur me kërkesën e tij të parashtruar për qasje në dokumente publike.

Më datë 15.05.2023, Agjencia ka pranuar një shkresë përmes postës elektronike nga kontrolluesi i të dhënave, në të cilin kontrolluesi ka njoftuar Agjencinë se: *“Të gjitha dokumentet zyrtare që i drejtohen Zyrës së Kryeministrit duhet të kalojnë përmes Zyrës së Arkivës si Njësi për Administrimin e Dokumenteve përveç në ato raste kur një gjë e tillë është e rregulluar me ligj të veçantë.*

Në nenin 3 të Ligjit nr. 04/L-184 për Administrimin e Punës në Zyrë, përcaktohet:

1. Çdo institucion i Republikës së Kosovës është i detyruar që ta ketë njësinë e administrimit të dokumenteve.

2. Të gjitha dokumentet zyrtare duhet të kalojnë përmes njësisë për administrimin e dokumenteve, përveç në ato raste kur një gjë e tillë është e rregulluar me ligj të veçantë. 3. Në njësinë e administrimit të dokumenteve kryhen shërbime profesionale-teknike si: informimi mbi procedurat administrative, pranimi, evidentimi, shpërndarja e dokumenteve në institucionet përkatëse, klasifikimi dhe ruajtja e tyre. Të gjitha këto veprime kryhen edhe në mënyrë elektronike.

4. Në njësinë e administrimit të dokumenteve bëhet ruajtja e dokumenteve të pranuar, vënia e vulës së protokollit, data, evidentimi në evidencën themelore apo ndihmëse, dërgimi në njësinë e caktuar dhe pas përfundimit brenda institucional bëhet kthimi i lëndës në njësinë e administrimit të dokumenteve.

5. Në njësinë e administrimit të dokumenteve ruhen lëndët e kryera derisa të dorëzohen në arkiv, si dhe lëndët që janë me afat ligjor derisa të kompletohen dhe të bëhet shpërndarja e tyre.

Në nenet 4, 5, 6 të këtij Ligji përcaktohen: Përgjegjësitë e Njesisë për administrimin e dokumenteve, Protokollimi dhe evidentimi i akteve, Libri i protokollit dhe kështu me rradhë..

Edhe në rastin konkret, nuk qëndrojnë pretendimet e ankuesit z. Beqiri sepse Zyra e Personelit e ka dërguar ashtu siç parashih me ligj lëndën e pranuar nga KPMSHC në Zyrën e Arkivës (Bashkëlidhur gjeni sqarimin e Zyrës së Personelit të ZKM).

Zyra e Arkivës pas pranimi të lëndës ka kryer procedurat e parapara në nenet e lartë cekura të Ligjit dhe lëndën e ka dërguar te Zyrat përkatëse/Zyrtarët përkatës për përgatitjen e përgjigjes.

Zyra përkatëse/Zyrtari përkatës për ta përgatitur përgjigjen, duhet të bashkëpunoj edhe me zyrat e tjera në kuadër të Zyrës së Kryeministrit, ku secila prej tyre duhet të ofrojë kontributin e tyre, varësisht nga fusha e përgjegjësisë së tyre.

Si rrjedhojë shkresa përcjellëse së bashku me përgjigjen përmes udhëheqësve hierarkik shkon përsëri në Zyrën e Arkivit për tu regjistruar, e për tu lidhur me numrin e njëjtë të postës hyrëse dhe pastaj përsëri dërgohet te Zyra përgjegjëse dhe nga kjo zyrë përcillet te pala në formë fizike apo edhe elektronike. Në këtë rast kemi ankesën e z. Beqiri për komunikimin elektronik.

Në rastin konkret edhe vetë pala ankuese z. Beqiri është drejtuar KMPSHC-së me emal zyrtar, pra nuk ka përdorur ndonjë emal privat të tij. Ku në fund të emalit mund të informohemi me pozitën aktuale të tij, ministrinë ku ai punon, numrin e zyrës, objektit, numrin e telefonit.

Pra, në secilin rast kemi të bëjmë me komunikim zyrtar përmes sistemit elektronik i cili realizohet përmes postës elektronike, ashtu siç përcaktohet në nenin 13 Komunikimi zyrtar përmes sistemit elektronik të Ligjit nr. 04/L-184 për Administrimin e Punës në Zyrë.

Bazuar në Ligjin nr. 06/L -113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura ku parashihet hierarkia në Sistemin ministror dhe në Zyrën e Kryeministrit ku në nenin 18, paragrafi 2, Nenin 19 paragrafi 2 dhe Nenin 20 paragrafi 2, përcaktohet hierarkia ose vija e raportimit:

-Sekretari i Përgjithshëm i raporton dhe i përgjigjet drejtpërdrejt ministrit dhe ushtron detyrën nën drejtimin dhe udhëzimet e ministrit.

- Departamenti drejtohet nga drejtori i departamentit, i cili i raporton dhe i përgjigjet Sekretarit të Përgjithshëm.

- Divizioni udhëhiqet nga udhëheqësi i divizionit. Udhëheqësi i divizionit i raporton drejtpërdrejt drejtorit të departamentit, pjesë e të cilit është divizioni, përveç kur përcaktohet ndryshe me këtë ligj. Si përfundim, komunikimi zyrtar nëpërmjet sistemit elektronik ose me letër, duhet të realizohet përmes udhëheqësve të lartë të hierarkisë për konsultim, miratim apo edhe vetëm t'i lëmë të njoftuar siç është vepruar edhe në rastin përkatës.

Ligjit Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (LMDhP), në nenin 3, paragrafi 1, nën paragrafi 1.11, ka dhënë përkufizimi i shprehjes 'kontrollues i të dhënave' me të cilin nënkuptohet se kontrollues i të dhënave është çdo person fizik apo juridik nga sektori publik ose privat që individualisht ose së bashku me të tjerët përcakton qëllimet dhe mënyrat e përpunimit të të dhënave personale. Andaj, sipas këtij përkufizimi, Zyra e Kryeministrit, cilësohet kontrollues i të dhënave.

LMDhP, përcakton të drejtat, përgjegjësitë, parimet dhe masat ndëshkuese lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale dhe privatësisë së individit. Sipas nenit 3, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, të LMDhP-së, me të dhëna personale nënkuptohet çdo informacion në lidhje me një person fizik të identifikuar ose të identifikueshëm ("subjekt i të dhënave"); një person fizik i identifikueshëm është ai, i cili, mund të identifikohet drejtpërdrejt ose jo drejtpërdrejt, veçanërisht duke iu referuar një identifikuesi në bazë të një emri, një numri identifikimi, të dhënave rreth vendndodhjes, një identifikues online, ose një apo më shumë faktore specifike për identitetin fizik, psikologjik, gjenetik, mendor, ekonomik, kulturor ose social të atij personi fizik. Në kuptimin e kësaj dispozite, emri, mbiemri, adresa, dhe dokumenti identifikues i subjektit të të dhënave konsiderohet e dhënë personale dhe përpunimi i këtyre të dhënave duhet të bëhet në mënyrë të ligjshme.

Kur kemi të bëjmë me përpunimin e të dhënave personale, ligji, në dispozitat e tij ka dhënë kuptimin se cilat veprime konsiderohen si përpunim i të dhënave personale, gjegjësisht neni 3, paragrafi 1,

nënparagrafi 1.2, të LMDhP-së, përcakton se me **përpunim** nënkuptohet çdo veprim ose seri veprimesh që kryhen ndaj të dhënave personale me mjete automatike ose jo, si: mbledhja, regjistrimi, organizimi, strukturimi, ruajtja, përshtatja ose ndryshimi, tërheqja, konsultimi, përdorimi, publikimi nëpërmjet transmetimit, shpërndarja ose ofrimi, njësimi ose kombinimi, kufizimi, fshirja ose asgjësimi. Në kuadër të kësaj dispozite, nënkuptojmë se shpërndarja, përbënë përpunim të të dhënave personale dhe si i tillë, ky përpunim duhet të bëhet në mënyrë të ligjshme.

LMDHP, në nenin 4, ka përcaktuar parimet themelore për përpunimin e të dhënave personale që duhet respektohet me rastin e përpunimit të të dhënave personale, siç janë parimi i ligjshmërisë, parimi i kufizimit të qëllimit, parimi i minimizimit të të dhënave, parimi i saktësisë, parimi i kufizimit të ruajtjes, parimi i paprekshmërisë dhe konfidencialitetit dhe në fund parimi i llogaridhënies, i cili përcakton se kontrolluesi duhet të jetë përgjegjës dhe në gjendje të zbatojë përputhshmërinë e të gjitha parimeve të përcaktuara si më lartë.

Parimi i ligjshmërisë, drejtësisë dhe transparencës përcakton se të dhënat personale përpunohen në mënyrë të paanshme, të ligjshme dhe transparente, pa e cenuar dinjitetin e subjekteve të të dhënave. Parimi i ligjshmërisë, është një parim i rëndësie të veçantë për çështjen e bazës ligjore, pasi është një nga përbërësit kryesorë të nevojshëm që përpunimi të jetë i ligjshëm. Transparenca, nënkupton se kontrolluesi duhet gjithashtu t'u ofrojë subjekteve të të dhënave personale informacion të qartë dhe transparent në lidhje me qëllimin ose qëllimet e përpunimit të të dhënave të tyre personale dhe bazën ligjore për ta bërë këtë.

Ligjshmëria e përpunimit të të dhënave personale është kur zbatohet së paku një nga kriteret e paraparë në nenin 5 të LMDHP-së, me të cilën kontrolluesi do të legjitimonte përpunimin e të dhënave, që nënkupton se të dhënat personale duhet të përpunohen vetëm në përputhje me ligjin.

Sipas nenit 5, paragrafi 1, të LMDHP-së, përpunimi i të dhënave personale është i ligjshëm vetëm nëse zbatohet, të paktën, njëri nga kriteret e mëposhme: 1.1. nëse subjekti i të dhënave ka dhënë pëlqimin e tij për përpunimin e të dhënave të tij personale për një ose më shumë qëllime specifike; 1.2. nëse përpunimi është i domosdoshëm për përmbushjen e një kontrate, në të cilën subjekti i të dhënave është palë kontraktuese ose për të ndërmarrë veprimet lidhur me kërkesën e subjektit të të dhënave para lidhjes së kontratës; 1.3. nëse përpunimi është i domosdoshëm për respektimin e obligimit ligjor, të cilit i nënshtrohet kontrolluesi; 1.4. nëse përpunimi është i domosdoshëm për mbrojtjen e interesave jetike të subjektit të të dhënave ose personave të tjerë fizikë; 1.5. nëse përpunimi është i domosdoshëm për kryerjen e një detyre me interes publik ose për ushtrimin e autoritetit zyrtar që i është dhënë kontrolluesit; 1.6. nëse përpunimi është i domosdoshëm për qëllime të interesave legjitime të ushtruara nga kontrolluesi ose pala e tretë, përveç kur këto interesa tejkalohen nga interesat apo të drejtat dhe lirinë themelore të subjektit të të dhënave që kërkon mbrojtjen e të dhënave personale, veçanërisht nëse subjekti i të dhënave është fëmijë. Kjo nuk zbatohet për përpunimin e kryer nga autoritetet publike për përmbushjen e detyrave të tyre.

Në këndvështrimin e këtyre dispozitave, në rastin konkret, kontrolluesi ka bazën ligjore të përpunimit të të dhënave personale, në nenin 5, paragrafi 1, nënparagrafi 1.3. nëse përpunimi është i domosdoshëm për respektimin e obligimit ligjor, të cilit i nënshtrohet kontrolluesi, si dhe në paragrafin 1.5 po të këtij neni, i cili përcakton se përpunimi është i ligjshëm nëse përpunimi është

i domosdoshëm për kryerjen e një detyre me interes publik ose **për ushtrimin e autoritetit zyrtar** që i është dhënë kontrolluesit.

Mirëpo, përveç parimit të ligjshmërisë drejtësisë dhe transparencës, të paracaktuara në nenin 4, të LMDhP-së, kontrolluesi duhet të jetë në gjendje të zbatoj njëkohësisht edhe parimet e tjera të përcaktuara në këtë nen, ku në rastin konkret me rastin e dërgimit të njoftimit për protokollim të lëndës NJMBNJ, nga zyra e arkivit si dhe me rastin e dhënies së përgjigjes nga zyrtari për qasjen për kërkuesin (ankuesin), kontrolluesi nuk ka zbatuar parimin e paprekshmërisë dhe konfencialitetit të përcaktuar në nenin 4, paragrafi 6, të LMDhP-së, i cili ka përcaktuar se, të dhënat personale përpunohen në atë mënyrë që garantojnë siguri të përshtatshme të tyre, duke përfshirë mbrojtjen ndaj përpunimit të paautorizuar ose të paligjshëm dhe ndaj humbjes, asgjësimit ose dëmtimit aksidental, duke përdorur masa të përshtatshme teknike dhe organizative, pasi me dërgimin e njoftimit nga zyra e arkivit dhe dhënies së përgjigjes nga zyrtari për qasjen për kërkuesin, i është ofruar qasje në të dhëna personale edhe personave të cilët nuk janë përgjegjës/kompetent dmth të paautorizuar dhe me ky veprim bie në kundërshtim me bazën ligjore të përpunimit të të dhënave të cekur më sipër.

Në nenin 3, paragrafi 4, të Ligjit nr. 04/L-184 për Administrimin e Punës në Zyrë, përcaktohet se, në njësinë e administrimit të dokumenteve bëhet hapja e dokumenteve të pranuar, vënia e vulës së protokollit, data, evidentimi në evidencën themelore apo ndihmëse, dërgimi në njësinë e caktuar dhe pas përfundimit brenda institucional bëhet kthimi i lëndës në njësinë e administrimit të dokumenteve. Në këndvështrimin e kësaj dispozite, zyra e arkivit, është e obliguar që dokumentet e pranuar për arkivim të shpërndaj vetëm në njësitë përkatëse, që nënkupton në njësitë të cilat janë përgjegjëse për dhënien e përgjigjes në këtë rast në NJMBNJ, duke njoftuar vetëm personat përgjegjës sipas hierarkisë.

Neni 13, paragrafi 2,3 dhe 4, i Ligji Nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike, ka përcaktuar se, të gjitha kërkesat për qasje në dokumente publike, të cilat i drejtohen institucionit publik, i dërgohen njësisë apo zyrtarit përgjegjës për qasje në dokumente publike. Njësia apo zyrtari përgjegjës për qasje në dokumente publike, pas marrjes dhe shqyrtimit fillestar të kërkesës për qasje në dokumente publike, identifikon se cila është njësia përkatëse brenda institucionit publik që ka në posedim ose kontroll dokumentin e kërkuar. Pas lejit të qasjes sipas këtij ligji, njësia përkatëse brenda institucionit publik, këtë dokument, në përputhje me kushtet e parapara me këtë ligj dhe ligjet tjera në fuqi, ia dërgon kërkuesit të dokumentit.

Neni 11, paragrafi 2, i Ligji Nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike, ka përcaktuar se, zyrtari përgjegjës brenda institucionit publik (*nënkupton zyrtarin më të lartë administrativ të institucionit publik sikurse është përcaktuar në ligj*), me vendim, lejon ose refuzon qasjen në dokumente publike. Në këndvështrimin e kësaj dispozitive, zyrtari i përgjegjës për qasje në dokumente publike (*zyrtar administrativ në kuadër të institucionit publik, i caktuar për pranimin dhe regjistrimin e kërkesave të pranuar për qasje në dokumente publike*) pas lejit të qasjes me vendim të zyrtarit përgjegjës brenda institucionit me rastin e dërgimit të dokumentit/informatës kërkuesit, është i obliguar ti mbajë në dijeni (të informuar) vetëm personat përgjegjës, që në rastin konkret janë: zyrtari përgjegjës brenda institucionit publik dhe njësia përgjegjëse e cila ka dokumentin. Gjithashtu edhe në këtë rast, kontrolluesi nuk ka zbatuar parimin e paprekshmërisë dhe

konfidentalitetit të përcaktuar në nenin 4, paragrafi 6, të LMDhP-së, i cili ka përcaktuar se, të dhënat personale përpunohen në atë mënyrë që garantojnë siguri të përshtatshme të tyre, duke përfshirë mbrojtjen ndaj përpunimit të paautorizuar. Kjo pasi që me rastin e lejimit të qasjes në dokumente publike kontrolluesi ka shpërndarë të dhënat personale edhe tek një institucion tjetër, Ministria e Drejtësisë, që nuk ka qenë pjesë në proces. Fakti që pala ankuese është i punësuar në MD, nuk i jep të drejtë kontrolluesit të njoftoj edhe këtë institucion, pasi që ankesa e subjektit të të dhënave lidhur me një procedurë rekrutimi është ankesë personale që nuk nëdrlidhet me ushtrimin e funksionit të tij në këtë institucion.

Në nenin 31, paragrafin 1, nënparagrafi 4 të LMDhP-së është përcaktuar se kontrolluesi dhe përpunuesi ndërmerr hapa për të garantuar se çdo person fizik që vepron nën autoritetin e kontrolluesit ose të përpunuesit, i cili ka qasje në të dhëna personale nuk i përpunon ato, përveç se sipas udhëzimeve nga kontrolluesi, përveç se kur i kërkohet ta bëjë këtë nga ndonjë ligj specifik. Në kuptimin e dispozitave të lartcekura kontrolluesi është i obliguar që të kujdeset në vazhdimësi, që përpunimi i të dhënave personale të bëhet gjithmonë në harmoni me dispozitat ligjore. Me këtë rast, në këndvështrimin e këtyre dispozitave, bazuar në ankesën e pranuar dhe faktet i sipërpërmendura, konsiderohet se kontrolluesi, nuk ka ndërmarr hapat e duhura për të garantuar se të dhënat personale përpunohen në harmoni me LMDhP-në, konkretisht në harmoni me nenin 4 paragrafi 5, nenin 5, dhe nenin 31, të LMDhP-së.

Agjencia për Informim dhe Privatësi pas shqyrtimit të ankesës, vërtetimit të gjendjes faktike si dhe legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, bazuar në kompetencat e dhëna me Ligjin Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

[Nënshkruar më datë 22.04.2025]

Zyrtare për Inspektim

Këshillë Juridike:

Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamentin për Çështje Administrative, brenda afatit prej 30 ditësh. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Vendimi i dërgohet:

- Zyrës së Kryeministrit – kontrollues,
- Ankuesit,
- Arkivit të Agjencisë.